



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULAR

**“MBI PERCAKTIMIN E KRITEREVE PER PERFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBESHTETJES STUDENTORE PËR CIKLIN BACHELOR ME KOHË TË PLOTË, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”
VITI AKADEMIK 2021-2022.**

Nr _____ Prot

Tirane, më __. __. 202__

Kërkesa plotësohet në bazë të VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 (i ndryshuar).

TË DHENA TE PERGJITHSHME TË STUDENTIT KËRKUES
(Plotëso me gërma të mëdha, vendos shenjën X ose rumbullakos)

Emri		Datëlindja	/ /		
Atësia		Nr.i letërnjoftimit			
Mbiemri		Gjinia	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>	
Fakulteti		Cikli studimit	Bachelor		
Programi		Viti i studimit	I <input type="checkbox"/>	II <input type="checkbox"/>	III <input type="checkbox"/>

Unë kërkuesi paraqes Kërkesë për tu trajtuar me bursë, pasi jam student në UART dhe plotësoj kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi në IAL Publike. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë kërkesë, si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërës prej kushteve të renditura në vijim janë në dijeninë time, të sakta dhe janë dokumente zyrtare të marra në institucionet shtetërore të njohura me ligj. Shpreh dakortësinë time për përpunimin dhe verifikimin e të dhënave personale të mia.


Jam në dijeni se deklaramet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, si dhe paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për trajtimin me bursë.

Dokumentet shoqërues janë original ose kopje të noterizuara.

Kriteri 1 Studentë në nevojë: Studentë me aftësi të kufizuara

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për
- Punë (KMCAPI).
- Fotokopje të noterizuar të librezes së invalidit lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror



- Vërtetimin original që përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare.

Kriteri 2 Studentë në nevojë: Studentët të cilët i kanë të 2 (dy) prindërit me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me vendim të KMCA-se për punë

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e vendimit të KMCAP-it në emër të prindërve.
- Fotokopje të noterizuar të librezave të invalidit të prindërve të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.
- Vërtetimin original që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
- Certifikatë Familjare.

Kriteri 3 Studentë në nevojë: Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njesitë bazë të vetëqeverisjes vendore


Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vërtetim original për trajtim/perfitim ndihme ekonomike të plotë apo të pjesshme e vetëqeverisjes vendore.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

Kriteri 4 Studentë në nevojë: Studentët që kanë të 2 (dy) prindërit pensionistë ose njërin prind pensionistë dhe prindin tjetër të ndarë nga jeta

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vërtetim që prindërit marin pension.
- Në rastin kur vetëm njëri nga prindërit mer pension dhe prindi tjetër është ndarë nga jeta, duhet të paraqitet dhe Certifikata e vdekjes e prindit që është ndare nga jeta.
- Vërtetim Studenti pranë Fakultetit të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose Pasaportë).
- Certifikatë Familjare.



Kriteri 5 Studentë në nevojë: Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e librezës për perfitimin e statusit të jetimit lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror, ose Certifikatë vdekje që vërteton që ka humbur të dy prinderit.
- Dokument që vërteton që ka lindur jashtë martese.
- Vendim i gjyqtes ku është hequr e drejta prindërore e të dy prinderve ose është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton me.
- Dokument që vërteton që janë braktisur nga të dy prinderit dhe nuk i njihet identiteti i tyre.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

Kriteri 6 Studentë në nevojë: Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjyqtes të formës së prere


Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:


- Kopje e noterizuar e vendimit të formës së prere të gjyqtes për humbjen e kujdestarisë prindërore.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
- Certifikatë Familjare.

Kriteri 7 Studentë në nevojë: Studentet deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerezore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajnim si viktima të trafikut të qenieve njerezore

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se kanë përfituar statusin ligjor për trajtimin si viktima të trafikut të qenieve njerezore, lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
- Certifikatë Familjare.





Kriteri 8 Studentë në nevojë: Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për çështjet e Brëndshme dhe Ankesat, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, të konfirmuar nga Ministria përgjegjëse

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se studenti është fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për çështjet e Brëndshme dhe Ankesat, të Policisë së Mbrojtjes ndaj zjarrit dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
- Certifikatë Familjare.

Kriteri 9 Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore të ponderuar 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) të vitit paraardhës akademik, të përlogaritur me kreditet dhe nota të atij vitit akademik. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.

- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Listë notash të vitit paraardhës me mesatare të ponderuar.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).


Kriteri 10 Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlogaritur si mesatare e thjeshtë e këtyre treguesve:


- Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm e të lartë.
- Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Kriteri 11. Studentë në nevojë: Studentët (bashkëshortë) që kanë fëmijë dhe janë të 2-(dy) studentë, përfitojnë secili bursë financiare

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vërtetim Studenti të bashkshortit/bashkshortes pranë Fakulteteve përkatëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Vërtetim Studenti pranë Fakultetit të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose Pasaportë).
- Certifikatë Familjare.

Kriteri 12. Studentë në nevojë: Studentët që janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve, në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:



- Vërtetim Studenti të vëllezërve/motrave nga Fakultetet e tyre përkatëse.
- Vërtetim Studenti pranë Fakultetit të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose Pasaportë).
- Certifikatë Familjare.

KËRKUESI

Emri Mbiemri Nënshkrimi

